



Pranimi / Dorezimi Priloge / Priloge Receit / Delivery	17.11.2021	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5480/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.855/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.855/2021 të datës 07.10.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Batalioni Atlantiku", Nr. 61, Lagja Iliria në Gjilan, kundër masës disiplinore *Vërejtje me shkrim* të datës 16.09.2021 të shqiptuar nga Shefi i Sektorit për Planifikim në Komunën e Gjilanit, në çështjen juridike "masës disiplinore-vërejtje me shkrim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.11.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.855/2021 e datës 07.10.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. **Shfuqizohet** masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" e datës 16.09.2021 e shqiptuar ndaj ankuseses, si në piken 1 të këtij vendimi.
- III. **Obligohet** Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Zyrtari përgjegjës pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të zbatojnë këtë vendim, duke larguar masën disiplinore nga dosja personale e ankuseses në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja E e punësuar në pozitën e punës “Zyrtare për Planifikim Rural”, në Komunën e Gjilanit, me datë 07.10.2021, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesën me numër protokolli 4954/2021 të regjistruar me numër A.nr.855/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt – Shefi i Sektorit për Planifikim në kuadër të Komunës së Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.10.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Gjilani. Këshilli më datë 09.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjilanit, me njoftimin që: *“Lidhur me kërkesën tuaj për përgjigjeje në ankesë A.nr.855/2021 të datës 8 Tetor 2021 me objekt kontesti Masë disiplinore parashtruar nga ankuesja Masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj ankueses është shqiptuar nga Shefi i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor i DUPMM, Ju njoftoj se pa konsultë paraprake me NJP, andaj NJP nuk kam mundur të kthej përgjigjeje në kërkesën tuaj, sepse edhe dispozitat ligjore dhe nënligjore në të cilat bazohet shqiptimi i masës disiplinore nuk janë në zbatim. Nga sa u tha më sipër kërkojmë që lidhur me këtë çështje juridike të vendosni konform ligjit në Fuqi për LZP dhe Rregulloren (QRK) për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4954/2021 të regjistruar me numër A.nr.855/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 07.10.2021 nga ankuesja; Shkrimin e datës 15.09.2021 të publikuar në Redaksinë “Rajoni Pres”; Njoftimin e datës 16.09.2021 për masën disiplinore vërejtje me shkrim ndaj ankueses; Kërkesën për përgjigjeje në ankesë të datës 13.10.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 09.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës, ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” i është shqiptuar përmes shkeljes së dispozitave ligjore në fuqi, respektivisht shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, dhe Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik; si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, duke iu referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht shkresës me numër reference 07-350/01-110191/21 të datës 16.09.2021 ka konstatuar se Shefi i Sektorit për Planifikim në Komunën e Gjilanit, duke u bazuar në Ligjin Nr.152/2013 për Nëpunësit Civil dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, me datë 16.09.2021 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për shkak të shkrimit me titull “Amullia pandemike e planifikimit urban të komunës së Gjilanit” të publikuar me datë 15.09.2021 në Redaksinë RAJONIPRESS. Shqiptimi i kësaj mase disiplinore është bërë duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.152/2013 për Nëpunësit Civil, dhe

Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, gjegjësisht nenin 7 paragrafi 1.2 të kësaj rregulloreje.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se Shefi i Sektorit për Planifikim në Komunën e Gjilanit, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" ndaj ankueses, duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.152/2013 për Nëpunësit Civil, dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, gabimisht ka zbatuar ligjin material sepse Ligji Nr.152/2013 për Nëpunësit Civil, nuk është i aplikueshëm në Republikën e Kosovës, ndërsa Rregullorja Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil është shfuqizuar me datë 27.08.2020, datë kjo kur ka hyrë në fuqi Rregullorja Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik. Andaj, duke marr parasysh se rasti disiplinor nuk është trajtuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe rrjedhimisht Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, Kolegji konstaton se masa disiplinore andaj ankueses është shqiptuar në kundërshtim me ligjit material dhe rrjedhimisht vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankueses është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji, po ashtu konstaton se masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" e shqiptuar ndaj ankueses është në kundërshtim edhe me dispozitat e aplikueshme që përcaktojnë elementet e detyrueshme të aktit administrativ, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe rrjedhimisht vendimi për shqiptimin e masës disiplinore është i paligjshëm edhe në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.855/2021

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

